




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim
Uprava za Obrazovanje/Department of Education

Nr prot.05/195

Datë 11.04.2024

**PROCESVERBAL NGA DISKUTIMI PUBLIK ME QYTETARË PËR DRAFT-
PLANIN E VEPRIMIT KUNDËR BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË
SHKOLLIMIT**

E mbajtur më datë 26 mars 2024 (e martë) duke filluar nga ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës së Shtimes

Pjesëmarrës në takim: Yllka Fejzullahu, Lulzim Sahiti, Besnik Shala, Rexhep Hasani, Afërdita Beha Ferati, Xhylferije Shahini, Bashkim Ramadani, Abdyl Hajredini, Donjeta Qorrolli, Valmira Hoxha, Sadbere Halili, Lutfi Gashi, Labinot Rexhaj, Festim Rexha, Lyra Kryeziu dhe Zejnepe Hysenaj.

Mbledhja është hapur nga Lulzim Sahiti ud Udhëheqës i Sektorit të Arsimit i cili para të pranishmëve prezantoi qëllimin e takimit.

Lulzim Sahiti: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, ashtu si jeni njofuar sot po mbahet dëgjimi publik për draft planin e veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollimit, draft ky i cili i është prezantuar Kuvendit të Komunës së Shtimes dhe i njëjti ka vendosur që ta dërgojë në diskutim publik e pastaj pas diskutimit publik të dërgohet pëmiratim. Me këtë rast po ja kaloj fjalën edhe drejtoreshës komunale të arsimit.

Yllka Fejzullahu: Fillmisht uroj komisionin që e ka realizuar punën në përgatitjen e planit i cili në koordinim me MASHTI - in dhe me ekspertë të shoqërisë civile e kanë përgatitur këtë plan mjaft të nevojshëm për institucionet tona shkollore e në veçanti për nxënësit tanë.

Lulzim Sahiti: Për të prezantuar draft- planin e veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollimit në emër të komisionit që e ka hartuar këtë draft ftojmë Besnik Shalën që të paraqes draftit.

Besnik Shala: përshëndetje të nderuar të pranishëm, në emër të komisionit për draftimin e planit të veprimit kundër braktisjës dhe mosregjistrimit të shkollimit i cili ka këtë përbërje: unë Besnik Shala- zyrtar për arsim, Tringa Rushiti-zyrtare për arsim, Labinot Rexhaj- ud drejtor i Institucionit për Arsim dhe Aftësim Profesional në Shtime, Afërdita Beha Ferati- drejtoreshë e ShFMU “Abdullah Shabani” në Carralevë dhe Rexhep Hasani drejtor i ShMU “Emin Durkau” në Shtime ju njoftoj se si ekipë punuese kemi mbajtur 3 mbledhje punuese ku kemi hartuar formularë të nevojshëm me qëllim të marrjes së informacioneve nga shkollat të cilat na kanë shërbyer për të krijuar kontekstin e këtij plani. Vlen të theksohet se ky draft plan është përgatitur në mbështetje të plotë nga MASHTI dhe ekspertë të angazhuar nga shoqëria civile.

Të nderuar të pranishëm qëllimi i këtij plani është që të bëhet koordinimi i veprimeve ndërinstitucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për prandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e baktisjes.

Po ashtu para të pranishmëve z.Besnik Shala shpalosi edhe objektivat e planit dhe listën e aktivitetave sipas objektivave.

Abdyl Hajredini: Falëminderit për këtë elaborim të këtij plani, më duhet ta parashtroj një pyetje sa është numri i nxënësve që kanë braktisur shkollimin

Besnik Shala: “Ashtu siç e ceka edhe më herët, konteksti i këtij drafti është hartuar duke u bazuar në raportet e shkollave, në nivelin që të shkollimit (nga klasa 1 deri në klasën e 5) nuk ka nxënës që kanë braktisur shkollimin, në nivelin 2 të shkollimit (nga klasa e 6 deri në klasën e 9) janë gjithsej 6 nxënës, e po ashtu në shkollën e mesme të lartë (nga klasa e 10 deri në klasën 12).

Abdyl Hajredini: ‘Sipas këtyre raporteve po del se ka shumë pak braktisje të shkollimit nga ana e nxënëve, mirëpo më intereson t’i pyes drejtoret e pranishëm në këtë takim se cilat janë shkaqet e braktisjes së shkollimit?’

Rexhep Hasani: “Shkaqet janë ngamë të ndryshme andaj edhe veprimet e planifikuara në këtë draft plan janë të natyrave që paraqiten si aspekti social ekonomik, familjar që janë ndër shkaktarët kryesor që ndikojnë në paraqitjen e kësaj dukurie shqetësuese në shkolla. Sa i përket institucionit tonë shkollor ju njoftojmë se e kemi ekipin për parandalim deh reagim ndaj braktisjes së shkollimit në nivel të shkollës i cili falë punës së mirë ka arritut të kthej nxënës që kanë pasur potencial për braktisje

Zejnepe Hysenaj: Nuk arrita tē shoh vizualisht këtë plan, sa i përket pyetjes së profesorit Abdyl lidhur me shkaktarët e braktjes së shkollimit nga ana e nxënësve aktualisht potencial më tē madh për braktisje tē shkollimit janë rastet kur nxnësit po paraqesin kërkesa për t'u liruar nga procesi mësimor dhe krej kjo pas liberalizimit tē vizave”

Labinot Rexhaj: “Ashtu si e cejku edhe Besniku gjatë prezantimit ne si ekipë që e kemi draftuar këtë plan kemi kërkuar nga shkollat përmes një formulari kërkesa që janë nevojitur andaj edhe drejtoret e shkollave gjegjëse e kanë pasur mundësinë që përmes hartimit tē atij reporti tē jenë pjesë përbërëse e punës së ekipit.

Festim Rexha “Në shkollën tonë nuk ka raste tē braktisjes së shkollimit, kanë qenë tri raste me potencial tē braktisjes por falë punës së ekipit për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollimit në nivel tē shkollës ata nxënës aktualisht janë jashtë rrezikut pë braktisje”

Bashkim Ramadani: “Nxënës braktisës në shkollën tonë nuk kemi, por një dukuri e fundit që është paraqitë është shtuar nevoja e kérkesave tē prindërve për lejimin e nxënësve për udhëtim jashtë vendit”

Yllka Fejzullahu: “Po i shoh aktivitetet e përfshira në planin për reagim dhe padyshim që me realizimin e tyre do tē ndikohet në rëninen e kësaj dukurie”

Abdyl Hajredini: “Për fund dua ta jap një mesazh që ndërlidhet me fjalën mësues, Mësues është ai që gjen zgjifhje për çdo gjë”










Takimi përfundoi në ora 11:50



**LISTA E PJESËMARRËSVE NË KONSULTIMIN PUBLIK ME QYTETARË PËR
DRAFT-PLANIN E VEPRIMIT KUNDËR BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË**

SHKOLLËS 2024-2026

Shtime, më 26 mars 2024 (e marte)

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Institucioni | Nënshkrimi |
|-----|----------------------|--|---|
| 1 | Rexhep Hasani | SHFU "Emin Dukader" Shkolla "ABDULLAH SHABANI" |  |
| 2 | AFERDITA ŽEHA-FERATI | SHFU "ABDULLAH SHABANI" |  |
| 3 | Khyffenie Shahini | I.P. Albionia Asllani |  |
| 4 | BASHKIM LAMADANI | SHFU "HISIAN PRISHNITI" |  |
| 5 | Abdyl Hajredini | |  |
| 6 | Danjeta Gomelli | Z. për komunitetin me publikun |  |
| 7 | Malmina Hoxha | K.K |  |
| 8 | Sadberk Halili | K.K |  |
| 9 | Gulfi Gashi | SHFU "IORIZ AJETI" |  |
| 10 | Zeljnot Rexhaj | "IAAP" |  |
| 11 | Festim Rexha | SHFU "Dëshmorët e Kombit" |  |
| 12 | Lura Trajani | Sh.m.l., Naim Frashëri |  |
| 13 | Tefeqre Hyseni | Sml "Naim Frashëri" |  |
| 14 | Besnik Shala | DEA - Shkollë |  |
| 15 | | | |
| 16 | | | |